



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI PORTUAL Durrës
DIVIZIONI LIGJOR DHE ADMINISTRATËS

Nr. _____ Prot.

Durrës, më _____._____.2025

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT
FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

Data: 07.07.2025

Drejtuar:

Operatorit Ekonomik (OE) “LAVIVA TECHNOLOGIES” Shpk, me Nipt M01323012A me adresë: Tirane Rruga : "At Zef Valentini", Kompleks Magazina, Kati 1, Njësia Bashkiake 11, Tiranë 1001.

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) ☐

[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** **X**

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ **JO** **X**

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës: Shërbim

Lloji i Procedurës së prokurimit: “E Hapur - Mbi kufirin e lartë monetar”

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **REF-47486-05-09-2025**
“Mirëmbajtja e sistemeve të sigurisë për 3 vite” - 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj nga dita e nënshkrimit të kontratës.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 12.05.2025

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletin e Njoftimeve Publike Nr.25 datë 19 Maj 2025

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. “LAVIVA TECHNOLOGIES” Shpk me NIPT M01323012A me vlerë të ofertës ekonomike 40.700.025 (dyzet milion e shtatëqind mijë e njëzet e pesë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. “AES Communication” Shpk me NIPT K72220501E me vlerë të ofertës ekonomike 38.126.413,26 (tridhjetë e tetë milion e njëqind e njëzet e gjashtë mijë e katërqind e trembëdhjetë presje njëzet e gjashtë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. “NAOL” Shpk me NIPT L92201032D me vlerë të ofertës ekonomike 0 (zero) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

4. “Advanced Business Solutions - ABS” Shpk me NIPT K21710002J me vlerë të ofertës ekonomike 31.879.324,80 (tridhjetë e një milion e tetëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e treqind e njëzet e katër presje tetëdhjetë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. “AES Communication” SHPK

K72220501E

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

arsyet e mëposhtme

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Në dokumentacionin e dorëzuar në rrugë shkresore nga “**AES Communication**” Shpk me Nr.1945 dhe datë 24.06.2025 në përputhje me parashikimet e nenit 26 të VKM 285 me datë 19.05.2021 i ndryshuar, KVO ka evidentuar mangësi:

Në kuadër të procesit të vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik, është shqyrtuar përmbushja e kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konkretisht:

“Punonjës i certifikuar për serverat e infrastrukturës ekzistuese nga prodhuesi ose ekuivalent”

Operatori ekonomik ka paraqitur:

Një certifikatë trajnimi nga ReBorn sh.p.k., në emër të Z.Ermal Shehu, për temën “Instalimi, konfigurimi, administrimi dhe mirëmbajtja e serverave”;

Një certifikatë për përfundimin e kursit “CompTIA Server+ (SK0-005)” në platformën Coursera, në emër të Z.Klinton Pajo, realizuar nga ofruesi i përmbajtjes Packt.

a) Certifikata nga ReBorn sh.p.k.:

Kjo është një dëshmi pjesëmarrjeje në një trajnim, dhe nuk përbën një certifikim teknik të vlefshëm:

Dokumenti i paraqitur nuk është lëshuar nga HPE (Hewlett Packard Enterprise) apo ndonjë partner i akredituar certifikues i HPE ose ekuivalent.

b) Certifikata për “CompTIA Server+” në Coursera:

Dokumenti i paraqitur nuk është certifikata zyrtare e CompTIA, por thjesht një dëshmi përfundimi kursi online në platformën Coursera, ofruar nga “Packt”. Nuk është lëshuar nga vetë CompTIA, e cila ka procedura të qarta për testimin dhe lëshimin e certifikatave përmes rrjetit të autorizuar të provimeve (p.sh., Pearson VUE);

Në tekstin e certifikatës theksohet se është përfunduar një “non-credit course”, çka do të thotë se nuk ka fuqi certifikuese teknike;

Nuk provohet kalimi i provimit zyrtar të CompTIA Server+, i cili është kusht për përfitimin e certifikatës zyrtare.

Operatori nuk ka paraqitur asnjë certifikatë të vlefshme teknike nga prodhuesi i serverave (HPE) dhe as një certifikim ekuivalent të njohur ndërkombëtarisht. Për rrjedhojë, ky kriter nuk konsiderohet i përmbushur.

2. “Punonjës i certifikuar nga prodhuesi për ndërtimin e sistemeve të integruar Bosch Security Systems ose ekuivalent”

Operatori ekonomik ka dorëzuar një certifikatën “Building Integration System”, lëshuar nga Bosch, në emër të Znj.Elena Angjeli, me datë 19 Qershor 2015. Sipas politikave zyrtare të Bosch Security Systems, të publikuara në faqen zyrtare të prodhuesit, certifikatat teknike kanë vlefshmëri 2 vjeçare nga data e lëshimit. Certifikata e paraqitur nuk është më e vlefshme; Komisioni ka kërkuar verifikim zyrtar të vlefshmërisë së saj pranë përfaqësuesit rajonal të Bosch, z. John Chaikalis, i cili konfirmoi me email:

“The attached certificate is not valid anymore... officially they do not have a valid certificate.”

“Certifikata e bashkëngjitur nuk është më e vlefshme... zyrtarisht ata nuk kanë një certifikatë të vlefshme.” Bashkëngjitur ketij dokumenti do të gjeni komunikimin zyrtar.

Në mungesë të një certifikate të vlefshme nga Bosch, apo të ndonjë certifikate ekuivalente, operatori nuk e përmbush këtë kriter teknik.

3. “Punonjës i certifikuar për CCNA ose ekuivalent”

Certifikata e paraqitur: “Grandstream Certified Specialist – Networking Solution”, në emër të z. Spiro Angjeli. Kjo certifikatë nuk përfaqëson një certifikim profesional ndërkombëtar në fushën e rrjeteve, por thjesht një trajnim për përdorimin e produkteve specifike.

Certifikata Grandstream trajton vetëm konfigurimin e produkteve të vetë Grandstream dhe nuk mbulon koncepte thelbësore të rrjeteve, siç janë:

- o modelet OSI dhe TCP/IP
- o routing statik/dinamik (OSPF, EIGRP)
- o VLAN dhe trunking
- o subnetting, ACL, NAT
- o troubleshooting i rrjeteve të avancuara

Bazuar në përmbajtjen e kufizuar teknike, certifikata “Grandstream Certified Specialist Networking Solution” nuk është teknikisht ekuivalente me CCNA. Operatori nuk e përmbush këtë kriter teknik.

2. “NAOL” SHPK

L92201032D

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

arsyet e mëposhtme

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Në dokumentacionin e paraqitur nga ky operator, KVO ka evidentuar mangësi.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga Operatori Ekonomik **“NAOL” shpk NIPT L92201032D** rezulton se operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë ofertë ekonomike.Më konkretisht opertaori:

Nuk ka paraqitur asnjë dokument në lidhje me përmbushjen e kriterëve të kualifikimit të kërkuara në dokumentet e tenderit, si kapaciteti profesional, teknik, financiar, përvoja, stafi i certifikuar etj., ofertën ekonomike dhe nuk përmbush asnjë nga pikat e kërkuara në DST.

3. “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK K21710002J

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

arsyet e mëposhtme

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Në dokumentacionin e paraqitur nga ky operator, KVO ka evidentuar mangësi.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga Operatori Ekonomik **“Advanced Business Solutions - ABS” shpk NIPT K21710002J** rezulton se oferta e operatorit ekonomik nuk i përmbush të gjitha kriteret:

Kriteri pika 2.3.5

Operatori ekonomik duhet te kete minimalisht 1 (nje) punonjes te certifikuar nga Prodhuesi per Sistemet e Akses Bosch Security Systems Kontrollit ose ekuivalent.

Certifikata “ACTi Certified Security Professional of CCTV Products” e paraqitur nga operatori ekonomik nuk e përmbush kriterin, pasi është e fokusuar në sistemet CCTV dhe jo në sistemet e kontrollit të aksesit. Edhe pse operatori ekonomik pretendon se komponenti “Access Control” është pjesë e trajnimit të certifikatës se paraqitur,nga shqyrtimi teknik rezulton se kjo certifikatë

nuk dokumenton një trajnim të veçantë, të plotë dhe të certifikuar për sistemet e kontrollit të aksesit. Certifikata mbulon përgjithësisht sisteme të mbikëqyrjes video (CCTV), ndërsa tematika e Access Control-it, edhe nëse përmendet, nuk trajtohet si modul më vete e cila është specifike dhe shume e rendesishme.

Kriteri nuk është i përmbushur dhe operatori nuk e ploteson në këtë pikë.

Operatori Ekonomik duhet te kete minimalisht 1(nje) punonjes te certifikuar nga prodhuesi per Sisteme Alarmi Bosch Security Systems seria G ose ekuivalent.

Operatori ekonomik ka paraqitur dy certifikata të ndryshme për të njëjtin punonjës ,një nga SATEL dhe një nga COMBIVOX ,në përpjekje për të përmbushur kriterin që kërkon një punonjës të certifikuar nga prodhuesi për Sisteme Alarmi Bosch Security Systems seria G ose ekuivalent. Megjithëse në përmbajtjen e kriterit përdoret formulimi “ose ekuivalent”, kjo duhet kuptuar si referim ndaj një certifikimi të vetëm dhe të plotë, të lëshuar nga një prodhues alternativ i krahasueshëm me Bosch për nga kompleksiteti i sistemeve, shkalla e integritetit, si dhe programi i trajnimit që ofron.

Në këtë rast, certifikata nga SATEL përfaqëson një trajnim bazë mbi produktet e tij, pa mbuluar funksionalitetet e sistemeve alarm të avancuara. Certifikata nga COMBIVOX, nuk mbulon në mënyrë të integruar funksionalitete të krahasueshme me ato që ofron Bosch seria G, si: arkitekturë e avancuar e sistemit, ndarje e zonave të mbrojtjes, skema komplekse alarmimi, ndërveprim me sisteme të tjera sigurie apo integrim në ambiente kritike. Bashkimi i dy certifikatave nga prodhues të ndryshëm, me përmbajtje dhe struktura të veçanta, nuk mund të përbëjë ekuivalencën e një certifikimi të vetëm, të unifikuar, që kërkon kriteri i specifikuar në dokumentet e tenderit. Certifikatat e paraqitura, as individualisht dhe as në kombinim, nuk përmbushin kërkesën për certifikim ekuivalent me Bosch Security Systems seria G.

Operatori Ekonomik duhet te kete minimalisht 1 punonjes te certifikuar nga prodhuesi Storage Bosch DIVAR IP ose ekuivalent.

Operatori ekonomik ka paraqitur si provë për përmbushjen e këtij kriteri certifikatën “HPE Master Accredited Solutions Expert Storage Solutions V4”, të lëshuar nga Hewlett Packard Enterprise (HPE), duke pretenduar se kjo është ekuivalente me një certifikim të prodhuesit për Storage Bosch DIVAR IP. Gjithashtu, operatori ka bashkëlidhur disa linke dhe burime zyrtare që tregojnë për bashkëpunime midis Bosch dhe HPE në fushën e teknologjisë së ruajtjes së të dhënave.

Pas analizës teknike të certifikatës së paraqitur dhe referencave shoqëruese, konstatohet se:

Certifikimi i kërkuar kërkon njohuri të thelluara për mirëmbajtjen e këtij sistemi që përfshinë konfigurimin e rrjedhës së pamjeve video, menaxhimin e storage-it të specializuar për video, integrimin me kamerat IP dhe sistemet e alarmit, dhe funksionet e rikuperimit të auditimit në kohë reale. Certifikata e paraqitur nga operatori i referohet një trajnimit për zgjidhje të përgjithshme të ruajtjes së të dhënave (storage dhe jo video), të fokusuara në mjediset IT dhe qendrat e të dhënave (data centers), duke përfshirë tematika si performanca e storage-it, arkitektura SAN/NAS,

virtualizimi, backup dhe storage për përdorime enterprise apo cloud. Kjo certifikatë nuk lidhet me sistemet e ruajtjes së të dhënave video (video surveillance storage) dhe nuk trajton teknologjitë specifike të ruajtjes CCTV, aq më pak ato të platformës Bosch DIVAR IP. Pavarësisht referencave që tregojnë për bashkëpunime të përgjithshme midis Bosch dhe HPE, duhet të theksohet se këto janë marrëdhënie në nivel korporativ dhe nuk përfaqësojnë një certifikim teknik të barasvlefshëm për mirëmbajtjen e DIVAR IP, as nuk vërtetojnë që punonjësi i certifikuar zotëron njohuritë e kërkuara për këtë platformë. Partneriteti i HPE me Bosch apo përdorimi i pajisjeve të HPE si server/storage në konfigurime të Bosch, nuk zëvendëson dhe nuk përmbush kërkesën për certifikim teknik të specializuar për produktin objekt kriteri.

Certifikata HPE Master Accredited Solutions Expert Storage Solutions V4 nuk është ekuivalente me certifikimin për Storage Bosch DIVAR IP.

Kriteri nuk është i përmbushur dhe operatori nuk e plotëson në këtë pikë.

Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht 1 (një) punonjës të certifikuar nga Prodhuesi për Ndërtimin e Sistemeve të Integruar Bosch Security Systems ose ekuivalent.

Certifikatat e paraqitura nga operatori ekonomik, përkatësisht ato të Milestone dhe Axis, janë të fokusuara në segmente të veçuara të teknologjisë së sigurisë (VMS dhe video IP) dhe nuk konsiderohen ekuivalente me një certifikim të unifikuar për ndërtimin e sistemeve të integruara të sigurisë fizike, siç kërkohet në kriter.

Operatori ekonomik, në përgjigje të kërkesës për sqarim mbi përmbushjen e këtij kriteri, për dy certifikata:

Milestone Certified Integration Engineer – Elvis Mece

Axis Communications Academy – Network Video Fundamentals – Dorian Stafa

Në shtjellimin e vetë operatorit, theksohet se këto dy certifikata paraqiten me qëllim për të mbuluar si aspektin e softuerit të menaxhimit të videove (VMS), përmes Milestone, ashtu edhe bazat e teknologjisë video IP përmes Axis, në mënyrë që të përmbushet kriteri për certifikim për sistemet e integruara Bosch ose ekuivalent.

Certifikata Milestone Certified Integration Engineer fokuson tërësisht aftësimin mbi konfigurimin dhe administrimin e sistemit VMS, përfshirë: instalimin e serverit dhe klientëve, lidhjen me kamerat, konfigurimin e rrjedhave video dhe përdoruesve. Ajo nuk përfshin ndërtimin e sistemeve të integruara që mbledhin e bashkërendojnë module të ndryshme sigurie si: kontrolle fizike të aksesit, alarme, audio, analitike të ngjarjeve dhe menaxhimin e të gjitha këtyre si një platformë unike integrimi. Milestone, në vetvete, është një platformë e hapur për menaxhimin e videove, por nuk është një prodhues i gjithë komponentëve të një sistemi të integruar (pra kamera, alarm, akses kontroll, panel alarmi, etj.), siç është Bosch. Ndërkohë, certifikata Axis Network Video Fundamentals është një trajnim bazë që mbulon vetëm konceptet themelore të rrjeteve IP, instalimin e kamerave Axis, dhe njohuri bazë për sistemet video. Nuk trajton integrimin e

sistemeve të ndryshme të sigurisë, nuk përfshin asnjë nivel konfigurimi për sisteme alarmi, akses kontrolli apo softuerë ndërveprues, dhe është i limituar në fushën teknike të transmetimit dhe konfigurimit të kamerave.

Gjithashtu, në sqarimin e vet, operatori vetë e pranon që këto certifikata janë të fushave të veçuara (Milestone për VMS dhe Axis për kamerat), por përpiket të argumentojë se “së bashku” ato përbëjnë një njohje të përgjithshme që përmbush kriterin.

Ky interpretim është në kundërshtim me qëllimin dhe strukturën e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, i cili kërkon një certifikim të unifikuar dhe të plotë nga prodhuesi (Bosch) ose një prodhues tjetër që ofron certifikim specifik për ndërtimin e sistemeve të integruara të sigurisë, dhe jo ndarje të fushave teknike në trajtime të pjesshme nga prodhues të ndryshëm.

Në këtë rast, as Milestone dhe as Axis nuk kanë lëshuar një certifikim të tillë të unifikuar. Secila certifikatë mbulon vetëm një komponent (VMS ose video IP), pa përfshirë konceptin e arkitekturës së një sistemi të integruar sigurie, siç ndodh me certifikimet e Bosch për integrim (p.sh. Bosch BIS Building Integration System).

Kjo nuk e bën certifikatën e një punonjësi për Milestone të barasvlefshme me një certifikim për ndërtim të sistemeve të integruara të sigurisë, që është një kompetencë më e gjerë, shumëplanëshe dhe që kërkon trajnim specifik në të gjitha komponentët që ndërtojnë një sistem të tillë.

Kriteri nuk është i përmbushur dhe operatori nuk e ploteson në këtë pikë.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “LAVIVA TECHNOLOGIES” Shpk me adresë: Tirane Rruga : "At Zef Valentini", Kompleks Magazina, Kati 1, Njësia Bashkiake 11, Tiranë 1001., se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 40,700,025 (dyzet milion e shtatëqind mijë e njëzet e pesë) lekë pa tvsh, është identifikuar si ofertues i suksesshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Kreshnik Bajraktari